



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2021:273784
Datë: 22.04.2024
Numri i dokumentit: 05599006

E.nr.566/23

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen përmbaremore të kreditorit M.B. nga fsh ..., Komuna e Vitisë, të cilën me autorizim e përfaqëson av Minir Arifi nga Vitia, kundër debitorit E.B. nga Ferizaj, rr "...", nr...., për pagesën e alimentacionit, më datë 19.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I.Propozimi i kreditorit M.B., i datës 24.02.2023, i ushtruar kundër debitorit E.B., për pagesën e alimentacionit **KONSIDEROHET I TËRHEQUR** dhe **SHFUQIZOHET** aktvendimi mbi lejimin e përmbaremit E.nr.566/23, i datës 28.04.2023.

A r s y e t i m i

Kreditori M.B., përmes të autorizuarit të saj, më datën 24.02.2023, ka parashtruar propozim për përmbare kundër debitorit E.B., për pagesën e alimentacionit për çdo muaj nga 250 euro, duke filluar nga data 01.10.2022, në bazë të aktgjykimit C.nr.1036/2021, të datës 06.09.2022.

Gjykata me aktvendimin E.nr.566/23, të datës 28.04.2023, e ka lejuar përmbaremin e propozuar nga i autorizuari i kreditores, kundër debitorit E.B.

Gjykata pas lejimit të përmbarimit, përveç të autorizuarit të kreditores ka tentuar që propozimin dhe aktvendimin mbi lejimin e përmbarimit t'ia dorëzoj edhe debitorit E.B., mirëpo nga fletë kthesa e kthyer nga dorëzuesi i gjykatës është konstatuar se adresa e debitorit e shënuar në propozimin për përmbarim nga i autorizuari i kreditorit është e panjohur.

Gjykata duke e parë një gjendje të tillë faktike, me konkluzionin E.nr.566/23, të datës 01.12.2023, e ka ftuar të autorizuarin e kreditorit, që në afat prej 7 ditësh, në pajtim me nenin 17, të LPP-së, lidhur me nenin 102, par 1, të LPK-së, ta plotësoj propozimin për përmbarim, duke e shënuar adresën e saktë të debitorit, nën kërcënimin se Gjykata do të veproj sipas dispozitave të nenit 102, të LPK-së.

I autorizuari i kreditorit, përkundër pranimin të konkluzionit të dërguar me shkrim nga Gjykata, ku vërtetohet se i njëjti e ka pranuar konkluzionin me postë me datën 08.12.2023, i njëjti nuk ka vepruar sipas konkluzionit.

Gjykata pas kalimit të afatit të dhënë në konkluzionin e datës 01.12.2023, ka konstatuar se i autorizuari i kreditorit nuk ka vepruar sipas konkluzionit të dërguar me shkrim nga Gjykata, respektivisht nuk e ka bërë plotësimin e propozimit për përmbarim sa i përket adresës së saktë të debitorit. Për më tepër, në dispozitën e nenit 38, par 1 dhe 2, të LPP-së, është paraparë si vijon: *“Propozimi për përmbarim duhet të përmbaj kërkesën për përmbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbarimi, kërkuesi i përmbarimit dhe debitori, **adresa e vendbanimit - vendqëndrimin apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet si dhe mjeti nëpërmjet të cilit duhet të kryhet përmbarimi, objekti i përmbarimit po që se është i njohur, si dhe të dhënat të tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarimit**”, më tej në paragrafin 2 të këtij neni thuhet : “në rast se propozimi për përmbarim nga paragrafi 1 i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbarues do të veproj sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të procedurës kontestimore”.*

Gjithashtu, Gjykata konstaton se në nenin 102, par 1, të LPK-së, është paraparë si vijon: *kur një parashtrësë nuk arrin të jetë e kuptueshme dhe e plotë, siç kërkohet në paragrafin 2 të nenit 99, gjykata do ta thërras personin që e dërgon ta korrigjoj ose ta plotësoj parashtrësën. Në një rrethanë të tillë gjykata e udhëzon palën për korrigjimet dhe plotësimet që do të zënë vend dhe e cakton një periudhë tre ditore për korrigjimin dhe për plotësimin e parashtrësës”. Më tej në nenin 102, par 3, të LPK-së, është paraparë: “Do të konsiderohet se është tërhequr parashtrësja po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar gjegjësisht pa u plotësua, parashtrësja do të hidhet poshtë”.*

Si përfundim, Gjykata konsideron se meqenëse i autorizuari i kreditorit nuk ka vepruar sipas konkluzionit të datës 01.12.2023 edhe për kundër vërejtjeve për të metat e propozimit për përmbardim, i njëjti nuk i ka eliminuar siç parashihet me nenin 38, të LPP-së se çka duhet të përmbard propozimi për përmbardim, Gjykata veproj në bazë të nenit 17 dhe 38, par 1 dhe 2, të LPP-së, lidhur me nenin 102, të LPK-së, dhe propozimin për përmbardim të kreditorit, të ushtruar më datë 24.02.2023, kundër debitorit E.B., e konsideroj si të tërhequr.

Andaj, Gjykata duke u bazuar në nenin 17, 38, par 1 dhe 2, lidhur me nenin 102, par 3, të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke e konsideruar si të tërhequr propozimin për përmbardim të kreditorit.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

E.nr.566/23, më datë 19.04.2024

Gjyqtari

Faton Ajvazi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë,
Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afatin prej 7 ditësh,
nga dita e pranimit të aktvendimit, përmes kësaj gjykate.